



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 129 Prot

Tiranë, më 20.09.2010

VENDIM Nr. 17 dt. 31.08.2010

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 31.08.2010, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**


**I. Lidhur me: Diskutimi i projekteve**

1. **Nuk miratohet:** Projekt mbi ndërhyrjet restauruese në mozaikun e fasadës së Muzeut Historik Kombëtar, Tiranë.
  - *Ngarkohet IMK të përgatisë projektin e plotë të fasadës së Muzeut Historik Kombëtar.*
2. **Miratohet në parim:** Projekt restaurimi, banesa e Z. Rakip Caca, lagja Meçite Gjirokastër
3. **Miratohet:** Projekt rikonstruksion dyqani, me pronar Z. Behar Qypi, Berat. **Me kushtin:**
  - *Të mos ketë asnjë ndryshim në volumetri dhe në fasadë.*
4. **Miratohet:** Kërkesë e shoqërisë "ZOAN" shpk, për miratim të fillimit të punimeve të ndërtimit të vilave në komunën Petrelë.
5. **Miratohet:** Kërkesë për ndërtim Avdes'hane dhe Gusulane në xhamia e Iliaz Bej Mirahorit, Korçë.
6. **Miratohet:** Projekti i rikonstruksioni dhe restaurimit të banesës 3 kate + bodrum, me pronar Ilirian Dendallinji, rruga kryengritja e Qershorit, nr. 3. Korçë, **me kushtin:**
  - *Projekti të jetë në përputhje me VKM për qytetin e Korçës si dhe me ligjin në fuqi.*
7. **Miratohet:** Projekt Rikonstruksion banese dhe shtesë anësore dy kate, investitor Liljana Pavliqi, Korçë.

8. **Miratohet:** Rikonstruksion banese dy katëshe + bodrum, investitor Angelo Kondili. Korçë.
9. **Miratohet:** Projekti i ndërtimit të Qendrës Tregëtare “Shtëpia 2012” me investitor Pirro Kapurani, lagja 11, bulevard “Republika”, Korçë, **me kushtin:**
- *Ngarkohet IMK të shikojë përputhshmërinë me vendimin nr. 455, neni 8, të VKM në fuqi për Qendrën Historike të qytetit të Korçës.*
10. **Miratohet:** Projekt restaurimi dhe ngritje kati banese, me pronar Z. Thomaq Beta, Korçë.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR I KKR  
AKADEMIK. APOLLON BAÇE**



**KRYETAR  
FERDINAND XHAFERRAJ**

